

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË “QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE NËNË TEREZA”, TIRANË.

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në “Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë, me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 01.01.2014 deri më 30.09.2015 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 37, datë 12.04.2016. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën Nr. 789/12, datë 15.04.2016, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar znj. Ogerta Manastirliu, Drejtor i Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi u konstatua se si për vitin 2014 ashtu edhe për vitin 2015, buxheti i miratuar ka ndryshuar disa herë, duke pasur shtesa dhe pakësim të fondeve. Konstatohet se vlerën më të lartë të këtyre shpenzimeve e zë artikulli 602.1 “materiale dhe shërbime të tjera speciale” në të cilën përfshihen barnat, materialet mjekësore, oksigjeni i lëngshëm, protoksidi i azotit, ushqimi, lavanderia dhe hemodializa. Ky zë përbën rreth 75% të fondeve të programuara. Konstatohet se QSUT në pozicionin e njësisë shpenzuese në bashkëpunim me FSDKSH, si institucion, i cili ka detyrë shpërndarjen e buxheteve të shpenzimeve korente për njësitë var tëse nuk kanë bërë detajimin e buxhetit për vitin 2015. Gjithashtu konstatohen pasaktësi në shumën e programuar, kështu në praktikën dokumentare të QSUT, buxheti për tu detajuar paraqitet me 4,397,760 mijë lekë, kurse në urdhrin e brendshëm të titullarit të QSUT-së, urdhërohet detajimi i buxhetit për vlerën prej 3,500,000 mijë lekë (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 11-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa të menjëhershme që programimi i buxhetit ti largohet praktikave formale dhe mungesës së vlerësimit të nevojave reale, duke eliminuar kështu ndërhyrjet e herëpashershme gjatë zbatimit të programeve buxhetore. QSUT si njësi shpenzuese, të marrë të gjitha masat për detajimin e buxhetit, vetëm mbi bazën e praktikave të plota dokumentare, të shoqëruara me shkresa zyrtare të MSH/FSDKSH, deri në nivel artikulli.

Në vazhdimësi

2. Gjatë auditimit të ndryshimeve të buxhetit të vitit 2014 (shtesa/pakësime/transferime), u konstatuan 6 raste të shtesave të fondeve buxhetore për investime, nga Ministria e Shëndetësisë, me emërtimin “fonde të ngrira”, me një vlerë rreth prej 70,000 mijë lekë. Për këto shpenzime investimesh nuk jepen përshkrime apo sqarime se çfarë përfaqësojnë, ashtu sikurse ndodh me fondet për projektet e tjerë, të cilët janë të shoqëruar me emërtime konkrete (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 11- 15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

QSUT në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të pranojë fonde me destinacion të mirë përcaktuar zërash e nën zërash investimesh, si dhe me emërtime konkrete të projekteve, kjo duke rritur jo vetëm saktësinë e paraqitjes së fondeve por dhe transparencën e përdorimit të tyre.

Në vazhdimësi

3. Gjatë auditimit të monitorimit të realizimit të buxhetit të vitit 2014, u konstatua se në situacionin përfundimtar të shpenzimeve për vitin 2014, në kolonën plan të artikullit “Paga, shpërblime e shpenzime të tjera personeli”, si dhe të artikullit “Transferta buxhete familjare/

llog. 606”, nuk janë të njëjtat vlera me ato të raportuara/paraqitura nga Sektori i Buxhetit, i cili është pjesë përbërëse e Drejtorisë Ekonomike. Konstatuam se në situacionin përfundimtar, të nënshkruar e vulosur edhe nga Dega e Thesarit Tiranë, vlera e artikullit “Paga, shpërblime e shpenzime të tjera personeli” në kolonën plan nuk ka të përfshirë ndryshimin në pakësim prej 50,000 mijë lekë të VKM nr. 638, datë 01.10.2014, ndërsa nga Sektori i Buxhetit kjo vlerë është përfshirë. I njëjti fenomen u konstatua edhe për artikullin “Transferta buxhete familjare/llog. 606”, i cili duhet të raportohet në kolonën plan me një vlerë 87 mijë lekë më tepër.

Parregullsitë e evidentuara kanë ndikuar në paraqitjen jo reale të realizimit të shpenzimeve, por pa pasur tejkalim të fondeve të miratuara (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 11- 15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

QSUT-ja për të ardhmen, të marrë të gjitha masat e nevojshme për të reflektuar me përgjegjësi në situacionet përkatëse të gjitha ndryshimet buxhetore të paraqitura nga Qeveria, nga Ministria e Financave/Ministria e Shëndetësisë gjatë gjithë vitit. Të përmirësohet komunikimi institucional midis hallkave të saj dhe në tërësi, duke dhënë informacionin e nevojshëm në kohën e duhur, çka do të ndihmojë në marrjen e masave të duhura, për programimin/realizimin dhe paraqitjen e shpenzimeve deri në nivel artikulli me vërtetësi.

Në vazhdimësi

4. Gjatë auditimit të saktësisë së paraqitjes së zërave në pasqyrat financiare dhe formatet përkatëse, u konstatuan problematika dhe pasaktësi që të bëjnë të shprehesh me rezerva për çështje të caktuara të lidhura me mbylljet vjetore.

a. Kështu konstatuam pasaktësi në vlerën e pasqyruar si amortizim të akumuluar, pasi nuk është llogaritur amortizimi vjetor për çdo aktiv, si dhe nuk janë pasqyruar shtesat dhe pakësimet në fund të vitit ushtrimor. Konstatuam pasaktësi në normën e përdorur të amortizimit për pajisjet kompjuterike, informatike dhe në metodën e amortizimit të përdorur.

b. Konstatuam se vlera sipas inventarit fizik të pajisjeve, dhe vlera sipas kontabilitetit nuk janë të barabarta duke reflektuar një sërë pasaktësish në evidentimin e aktiveve që janë në shfrytëzim pranë QSUT. Mangësi që vjen edhe nga mungesa e regjistrit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, në të cilin duhet të paraqitet për çdo aktiv data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme, që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes etj. QSUT-ja nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve.

c. Në pasqyrën “Formati nr. 6”, ku pasqyrohet gjendja e AQT, është paraqitur mos kuadrimi i inventarizimit të përgjithshëm të pajisjeve mjekësore, që prej vitit 2008, me vlerë përfundimtare **146,305,574 lekë**. Kjo vlerë është pasqyruar edhe në bilancin e vitit 2014, në llogarinë aktive me nr. 28 “Caktime”. Për vitin 2015, nuk është kryer më ndonjë veprim, kjo në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, Kapitulli III (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 18 - 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria Ekonomike nëpërmjet Sektorit të Financës si dhe Sektorit të Informatikës të saktësojë evidentimin e pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në nënllogarinë sipas strukturës së llogarive në sektorin publik, si dhe të rillogarisë amortizimin sipas normave të miratuara dhe metodës së lejuar në sektorin publik. Ndërkohë QSUT të marrë masat e nevojshme për të bërë rakordimin midis inventarit fizik dhe kontabilitetit të pajisjeve mjekësore.

Të merren masa për të krijuar dhe mbajtur regjistrat e AQ Trupëzuara, llogarisë 212 sipas vlerës fillestare, vlerës së mbetur, normës së amortizimit dhe amortizimin e akumuluar për çdo objekt.

Brenda muajit Maji 2016

5. Konstatuam një vlerë të konsiderueshme rreth 95 milion lekë në llogaritë “Kërkesë arkëtimi mbi debitorët”, ku përfshihen llogaritë analitike “Persona, paradhënie, gjoba”; “Debitor të ndryshëm” etj, me rreth 110 persona dhe subjekte të ndryshme, juridike, fizike, dhe penalitete, pa shpresë arkëtimi. Ndër këta debitorë ka edhe subjekte juridike që vazhdojnë të kenë aktualisht marrëdhënie me QSUT si: [REDAKTUAR] i cili ka detyrim me një vlerë prej 10,323,602 lekë, [REDAKTUAR] me vlerë detyrimi 1,212,864 lekë, [REDAKTUAR] me vlerë detyrimi 566,640 lekë, apo dhe kompanitë celulare [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] etj. Për të gjithë debitorët e mësipërm nuk konstatohet të jetë bërë ndonjë përpjekje për arkëtimin e detyrimeve. Konstatuam se llogaria 466 që pasqyron detyrimin prej 5 % të garancisë së kontratës për firmat ndërtuese, në vlerë 22,006 mijë lekë nuk është e shoqëruar me listat analitike (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 18 - 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria Ekonomike, të bëjë rakordimet dhe të ndjekë debitorët të cilët kanë një nivel të konsiderueshëm në zërat e pasqyrave financiare. Nga nëpunësi zbatues të merren në analizë shkaqet e krijimit të një situatë e tillë duke nxjerrë personat përgjegjës, pasi konstatohet se këto janë pasojë e mos funksionimit të komunikimit midis Drejtorisë Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë Ekonomike. Për punonjësit që largohen nga ky institucion, të mos ju bëhen likuidimet (deri në mos dhënien e librezës së punës) nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pa marrë dokument vërtetues se nuk i detyrohen institucionit. Të plotësohet analiza me garancitë e kontratave të cilat pasqyrohen në llogarinë 466.

Menjëherë

6. Midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe [REDAKTUAR] në datë 20.10.2010 është lidhur “Kontratë blerje për pajisje mjekësore ...”, me vlerë 7.100.000 euro. Objekti i kontratës ishte “Përmirësimi i pajisjeve mjekësore për Departamentin e Neurokirurgjisë të Spitalit “Nënë Tereza” Tiranë, Shqipëri. Financimi realizohet përmes një huaje koncesionare ...Termet dhe Kushtet e Kontratës jepen në Aneksin A deri në Aneksin I. Aneksi C i referohet “Trajnimi” dhe Aneksi D referon “Drafti i certifikatave”. Në pikën 4 të nenit 9 “Garancia” është përcaktuar se ... *Shitësi do të garantojë me prodhuesit e pajisjeve që për një periudhë prej 7 vjetësh pas datës së nënshkrimit të Kontratës, prodhuesit të jenë të aftë të plotësojnë nevojat e Blerësit për furnizimin dhe riparimin e pjesëve të patentuara të Shitësit që përdoren në Pajisje me tarifat e Shitësit në kohën e riparimit dhe vetëm pasi të jetë kryer parapagimi...*

Nga auditimi u konstatua se në dosje mungon raporti që tregon realizimin e trajnimit, përmbajtjen e trajnimit, cilët janë personat (mjekë, inxhinierë etj.) që kanë marrë pjesë në trajnim dhe për çfarë lloj pajisjes, nëse është arritur qëllimi që nëpërmjet implementimit të këtij projekti (trajnimi) u është mundur përdoruesve dhe stafit të suportit teknik të spitalit, të veprojnë dhe mirëmbajtje me minimumin e ndërhyrjeve (në pajisje) ... për të ulur kostot ... etj, sipas parashikimeve të Aneksit-it C, “Trajnimet” ku përcaktohet se ... Shitësi do të zhvillojë trajnim për Pajisjet për personelin e spitalit, që përfshin... (f) Kujdesin dhe mirëmbajtjen për përdoruesin dhe (g) Elementët e Sigurisë dhe Kujdesit.

Po tek Aneksi C “Trajnimi”, ndër të tjera është përcaktuar se ... *Trajnimi përbëhet nga dy pjesë kryesore Trajnimi i përdoruesve ... trajnimi i stafit teknik... pas trajnimit një raport do të vihet në dispozicion të blerësit (MSH/QSUT), cili punonjës ka marrë trajnimin dhe për çfarë lloj pajisje ... për të mundur mjekë, ndihmës infermierë dhe inxhinierë dhe personel teknik për një standard i cili lejon përdorimin efektiv profesional të plotë të pajisjeve ... kurset e trajnimit të stafit teknik do të ekzekutohen për të siguruar që mirëmbajtjen nga avaritë në përpunje me kufizimet e prodhuesit, si dhe mirëmbajtja*

parandaluese të mund të asistohet nga personeli i spitalit ...trajnimi i stafit teknik do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me spitalin...

Ndërkohë që pika 21.2.2, kërkon *“Shitësi do t’i japë Blerësit manuale për funksionimin dhe mirëmbajtjen për përdoruesit në lidhje me Pajisjet, të cilat i janë dhënë blerësit (MSH) etj”.*

Gjatë vitit 2014, MSH ka zhvilluar tender me objekt *“Mirëmbajtje e përqendruar e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Siemens”* dhe në zbatim të tij ka autorizuar QSUT të lidhë kontratë me OE mirëmbajtës. Vlera e kontratës është 133.141.200 lekë, për 7 pajisje për dy vjet. Në këtë kontratë shërbimi janë përfshirë dhe dy pajisje mjekësore me emërtim, skaner dhe akselerator me vlerë mirëmbajtje 79,560 mijë lekë të cilat janë pjesë e kontratës me vlerë 7.100.000 euro lidhur në Vjenë.

Nga auditimi konstatohet se përfshirja e dy pajisjeve skaner dhe akselerator në kontratën e shërbimit të *“Mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore ...”* në kundërshtim me sa është parashikuar në nenin 20 *“Trajnimi”*, dhe Aneksin C të kontratës së lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe A..... ka shtuar kostot e mirëmbajtjes në mënyrë të gabuar. Neglizhenca e treguar në mos përfitimin e të drejtave të rrjedhura nga kontrata bazë me A..... (trajnimi si e drejtë e pa përfituar e kontratës), ka sjellë përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore me vlerë 79,560 mijë lekë.

Dhënia e shërbimit të *“Mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore”* subjekteve privatë dhe jo realizuar nga vetë QSUT, ndërkohë që evidentohet se për 18 muaj që është realizuar kontrata nuk ka asnjë problematikë, zëvendësim pjese të dëmtuar/konsumuar për të shtatë pajisjet nën kontratën e shërbimit, tregon papërgjegjshmëri në administrimin e fondeve si nga QSUT dhe nga MSH që ka inicuar këtë procedurë prokurimi.

Me shkresën nr. 657, datë 10.2.2014, të OE kontraktor, QSUT është njoftuar se *... ka përfunduar periudha e garancisë për ... disa pajisje të markës “Siemens” ... objekt i kontratës ”* lidhur në midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe A....., në të cilën përfshihen dhe dy pajisjet akseleratorë dhe skaner. Në vijim të njoftimit subjekti shprehet se... *do t’ju luteshim që këto pajisje të përfshihen në kontratë mirëmbajtje ...*

Nga ky moment, deri datë 28.8.2014, kur është autorizuar lidhja e kontratës së shërbimit të *“Mirëmbajtje pajisje mjekësore...”* me subjektin privat, QSUT, ka pasur gjithë kohën e nevojshme për zbatimin e kushteve të kontratës, në respekt të pikës 24/2 të nenit 24 të kësaj kontratës në të cilën është përcaktuar se *... Kontrata do të përfundojë me përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve të të dyja palëve si përcaktohet në Kontratë.*

Gjithshtu, konstatojmë se në një material me emërtimin *“Pasqyrë teknike”* dërguar datë 17.4.2014 nga Operatori Ekonomik kontraktor për titullarin e QSUT, ndër të tjera, në germën *“B”* *“Rekomandime nga Siemens”* është sqaruar se: *... Siemens rekomandon 4 mirëmbajtje periodike në vit për akseleratorin linear.*

Prej datës 10.2.2014 deri datë 28.8.2014 pajisjet mjekësore nuk kanë qenë nën kontratë shërbimi, dhe për to nuk dokumentohet të jetë kryer ndonjë shërbim ose të jetë kërkuar ndonjë shërbim (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 91 - 95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Auditi i brëndshëm i QSUT të verifikojë edhe kontratat e mirëmbajtjes për pjesën tjetër të pajisjeve mjekësore (34 pajisje), të përfituara në zbatim të kontratës lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe [REDAKTUAR] duke përcaktuar vlerën e paguar në kundërshtim me parashikimet e kontratës bazë. E njëjta praktikë të ndiqet edhe për pajisjet mjekësore të prodhuesit [REDAKTUAR] shërbimi i mirëmbajtjes të të cilave realizohet nga subjekte privatë.

QSUT të marrë masa që për raste të trajnimit të stafit, për të shmangur këtë fenomen, të hartojë kontrata ku të specifikohet kushti që i trajnuari, të jetë i detyruar të rikthehet dhe të punojë në QSUT, për një afat jo më pak se 5 vjeçar.

QSUT në strukturën organike përfshin Sektorin e Njësisë Inxhinierike Klinike, i cili është i përbërë nga 7 inxhinierë IT etj, me detyra funksionale për shërbimin e mirëmbajtjes së aparaturave mjekësore. Në mënyrë që kjo strukturë të kthehet në një strukturë eficiente në realizimin e objektivave për të cilën është krijuar QSUT të organizojë/bashkërendojë punën me Ministrinë e Shëndetësisë që brenda një periudhe kohore sa më të shkurtër të trajtojë punonjësit e vet qoftë dhe duke rekrutuar punonjës shtesë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Nga auditimi u konstatua se shërbimi i dializës është shoqëruar me një dinamikë në rritje si të numrit të pacientëve dhe të vlerave të kontratave, me arsyetimin se ka pasur një tendencë gjithmonë në rritje të pacienteve me këtë diagnoze shoqëruar me mungesë të kapaciteteve spitalore dhe pajisjeve mjekësore në QSUT. Për vite me radhë kryerja e këtij shërbimi për një numër të caktuar pacientësh u ka kaluar spitaleve private respektivisht [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

Kontrata midis QSUT dhe shoqërisë [REDAKTUAR], është lidhur në vitin 2012 me afat 36 muaj. Objekti i kontratës është trajtimi me dialize i 102 pacientëve. Kosto e kontraktuar për një seance dialize është 10.309 leke dhe vlera vjetore e kontratës është 125.640.091 lekë me TVSH.

Kontrata midis QSUT dhe shoqërisë [REDAKTUAR] mban datën 2012 dhe ka një afat 36 muaj. Objekti i kontratës është trajtimi me dialize i 64 pacientëve. Kosto e kontraktuar për një seance dialize është 10.728 leke dhe vlera vjetore e kontratës është 62.174.175 leke me TVSH.

Me Vendim nr. 1 të Bordit në datë 10.06.2013 është miratuar rinovimi i kontratave dhe lidhja e kontratave shtesë deri 20% të vlerës së kontraktuar, duke vendosur edhe kushtin për trajtimin e pacientëve me 3 seanca në javë, kjo konform udhërrëfyesve botërorë të trajtimit të pacientëve me SRK. Nga auditim konstatohet se në zbatim të kontratave gjatë vitit 2014, është paguar për shërbimin e dializës vlera totale 497.702.044 lekë me TVSH.

<i>Shoqëritë e kontraktuara</i>	<i>Vlera e paguar me TVSH, 2014</i>
[REDAKTUAR]	317,107,270
[REDAKTUAR]	180,594,272

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga fondi i sigurimeve shëndetësore të detyrueshme të kujdesit shëndetësor në shërbimin spitalor” është miratuar kosto e një seance dialize, propozuar nga FDSKSH, në vlerën 10.670 lek/seancë plus marzhi i fitimit 5%, pra 11.204 lekë /seancë. Ky çmim është reflektuar menjëherë në shtesat e kontratave në fillim të muajit qershor, me objekt ndryshimin e çmimit me të dy spitalet.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës së shërbimit të hemodializës, konstatuam se nuk ekzistonte asnjë regjistër themeltar apo qoftë dhe ndonjë evidencë ku lehtësisht të evidentohet numri i pacientëve si dhe të dhënat mbi gjendjen klinike të tyre, e domosdoshme për të ndjekur nivelin e seancave të realizuara dhe faturimin e shërbimit nga spitalet e kontraktuara.

Drejtori i Përgjithshëm, me shkresë nr. 1649 prot datë 31.03.2014, i është drejtuar Ministrit të Shëndetësisë me një kërkesë për trajtimin me hemodializë të pacientëve me sëmundje renale kronike të cilët nuk mbulohen nga kontratat me dy spitalet private. Citohet ndër të tjera se nga fillimi i vitit 2013 këto spitalet vazhdojnë të trajtojnë 164 pacientë për [REDAKTUAR] nga 102 të përcaktuar në kontratë (62 pacientë më shumë se kontrata) si dhe në [REDAKTUAR] trajtohen 90 pacientë nga 64 pacientë të përcaktuar në kontratë (26 pacientë më shumë).

Ministria e Shëndetësisë me shkresë 2165/1 prot datë 04.04.2014 miraton pas faktit ofrimin e shërbimit me numrin aktual të të sëmurëve që trajtohen në spitalet e sipërcituar. Me shkresë 2165/2 prot datë 14.04.2014, Ministria e Shëndetësisë ri jep miratimin për ofrimin e shërbimit shtesë deri në numrin aktual të të sëmurëve që trajtohen në spitalet e sipërcituar,

duke saktësuar që çmimi do ti referohet VKM dhe jo vendimit të Këshillit Administrativ të FSDKSH

Me shkresë nr. 3589 prot datë 12.05.2014, drejtori i Drejtorisë së Administrimit Spitalor në Ministri të Shëndetësisë i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT për lidhjen e kontratës për ofrimin e shërbimit të dializës, për të gjithë të sëmurët që aktualisht trajtohen me dializë në Spitalin ■■■ 210 pacientë.

Konstatuam se kërkesa e bërë nga Shërbimi i Nefrologjisë për Drejtoren e QSUT mban datë 13.05.2014 dhe nr. 1469/4 të protokollit, për hapje procedure prokurimi të trajtimit me dializë të pacientëve me sëmundje renale kronike të cilët nuk mbuloen nga kontratat aktuale me dy spitalet private. Ky shërbim konfirmon se numri i pacientëve të trajtuar është 210 pacientë për ■■■ dhe 118 pacientë për ■■■ Vetëm në harkun kohor 1 muaj, numri i pacientëve është rritur me 78 pacientë.

Më datë 13.08.2014 me shkresë nr. 3607 prot, Drejtore e Përgjithshme i drejtohet Ministrit të Shëndetësisë lidhur me mënyrën si do të veprohet me kontratat për numrin shtesë të pacientëve të cilat kanë qenë 4 mujore dhe përfundojnë më 20.09.2014. Me shkresë 3885/3 datë 15.09.2014, Ministria ka dhënë miratimin për zgjatjen e kontratave deri në fund të vitit 2014. Nisur nga sa përshkruhet më lartë nga auditimi konstatohet se deri muajin Maj 2014 janë trajtuar jashtë numrit të përcaktuar në kontrata dhe të pa miratuara gjithsej 166 pacientë ose në vlerë mesatare 24.178.232 lekë mbi vlerat aktuale të kontratave.

Nga një sondazh mbi disa pacientë të trajtuar në QSUT për vitin 2014, sipas regjistrit të paraqitur dhe mbajtur nga Shërbimi i Nefrologjisë rezultoi se kishte pacientë të cilët rezultonin të ishin të përfshirë në listat e muajve ndërkohë që pjesa më e madhe e tyre nuk rezultonin në asnjë regjistër të shërbimit të nefrologjisë së QSUT (dokumentacioni që na u vu në dispozicion). Nuk na u paraqit nga shërbimi i nefrologjisë asnjë evidencë ku të përputhej lista emërore që ky shërbim mund të kishte lidhur me këta pacientë me listën emërore të pacientëve që merrnin shërbimin nga operatorët privat. Grupi i auditimit lidhur me listat emërore të pacientëve (328 pacientë) për të cilët paguhet shërbimi i dializës (viti 2014), shprehet me rezervë për vërtetësinë e tyre për sa kohë mungon regjistri themeltar i cili të përshkruaj për çdo pacientë kohën në të cilën është futur në shërbimin e dializës si dhe ecurinë klinike të tij (numrin e seancave të kërkuara).

Nga drejtorja e QSUT, në kundërshtim me kushtet e kontratës “Detyrimet dhe të drejtat”, ky shërbim nuk është monitoruar si nga ana sasiore dhe cilësore. Nuk ka asnjë raport për shërbimin e paguar por janë marrë të mirëqena dhe paguheshin të gjitha faturat që vinin nga operatorët privat pavarësisht se mund të kalonin limitet financiare të çdo kontrate.

Nga grupi i auditimit u konstatua se kushti i vendosur me vendimin nr. 1 të Bordit, për trajtimin e pacientëve me 3 seanca në javë, është hequr nga kontratat e lidhura gjatë vitit 2014. Si pasojë u konstatuan raste të raportimit të realizimit me 14,15 dhe 16 seanca në muaj për pacient. Nga tejkalimi i seancave për periudhën janar-dhjetor 2014 është paguar një vlerë 11.242.980 lekë për të dy operatorët ndërkohë që 9.667.194 lekë i kanë kaluar ■■■ Gjithashtu u konstatua se është faturuar dhe është bërë pagesa mujore për pacientë të trajtuar tek ■■■ të cilët figurojnë se janë larguar nga trajtimi në QSUT në fund të muajit. Në këto kushte operatori ekonomik është favorizuar për shkak të mungesës së monitorimit në vlerën 2.626.269 lekë. Nga ana e grupit të auditimit vazhdimisht u morën kontakte me mjekët e Nefrologjisë dhe u kërkuan dokumente shkresorë të cilët të vërtetonin besueshmërinë e listave të pacientëve që marrin trajtimin për dializë, informacion që nuk na u paraqit, ndërkohë që edhe observimet rreth konstatimeve tona kanë ardhur nga subjektit privat dhe jo nga Shërbimi i Nefrologjisë pranë QSUT, kur dihet se “ *Përveç kartelave të pacientëve, shërbimi i nefrologjisë mban dhe një regjistër themeltar me rubrika, nr rendor, datën e fillimit të dializës, emer mbiemër, gjinia, diagnoza, data e largimit..... Ky regjistër plotësohet nga Kreinfarmjeria e Pavijonit dhe nga rëndësia renditet mbas kartelës së pacientit*”.

Nga ana tjetër u konstatua se në zbatim të kontratave me spitalet private për shërbimin e dializës është paguar shërbimi i transportit për dializantët në vlerën 6.908.656 lekë (viti 2014). Nga auditimi u konstatua se asnjëherë pacienti nuk paguhej në bazë të numrit të seancave që kryente, ndërkohë që kishim raste që personi që listohet te shpenzimet e transportit nuk rezultonte të ishte në listat e pacientëve që faturoheshin për seancat që kryenin pranë spitaleve të operatorëve privatë. Kjo procedurë për vitin 2015 është e monitoruar dhe e plotësuar me dokumentacionin vërtetues të veprimit ekonomik (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 99 - 104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

QSUT të marrë masat e menjëhershme organizative për ngritjen e një regjistri themeltar, kombëtar (qoftë edhe në excel) në të cilin në çdo moment të evidentohen pacientët në mënyrë progresive, duke plotësuar për çdo pacient koha në të cilën është futur në shërbimin e dializës, ecuria klinike e tij.

Të hartojë një procedurë të shkruar dhe të mirë përcaktuar për mënyrën se si pacienti orientohet tek operatori privat për të marrë shërbimin e hemodializës, si dhe të përkufizojë mjetet për transparencën e këtij procesi.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2016

Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit Financiar në QSUT të bëjë verifikimin e numrit të personave që përfitojnë shërbimin e dializës pranë operatorëve privatë, të verifikojë numrin e seancave përmes kartelës klinike të pacientëve, si dhe të saktësohet data e hyrjes së pacientit në trajtim pranë këtyre operatorëve ekonomik duke llogaritur në këtë rast të gjithë vlerën e përfituar padrejtësisht nga operatorët ekonomik, kjo në mungesë të regjistrit të pacientëve që marrin shërbimin e dializës në vend. Të nxirret urdhër zhdëmtimi ndaj operatorëve ekonomik privat për shumën e pajustificuara me dokumentacion vërtetues për shpenzimin e transportit të përfituara nga pacientët sipas numrit të seancave të përfituara.

Menjëherë

8. Nga auditimi u konstatua se sipas inventarit fizik të pajisjeve për vitin 2013, vlera e inventarëve është 5.956.233.490 lekë ndërkohë që vlera sipas kontabilitetit më 31.12.2013, është 6.163.282.063 lekë, pra rezulton një diferencë prej 207.048.573 lekësh më tepër. Gjatë viti 2014 janë bërë rregullime për vlerën 146.305.574 lekë të diferencave të konstatuara nga inventarizimi i vitit 2013. Nisur nga niveli akoma i lartë i kësaj diference dhe nevojës për rritje të përgjegjshmërisë manaxheriale të munguar ndër vite në këtë institucion lidhur me administrimin e pronës shtetërore (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 36 - 42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit Financiar të përfundojë evidentimin e AQT të cilat nuk janë regjistruar në inventarët fizik të QSUT me qëllim që të saktësohet niveli i pajisjeve në dispozicion dhe të forcohet kontrolli dhe përgjegjësia individuale dhe manaxheriale në administrimin e tyre. Për të gjitha diferencat (si në plus dhe minus) të nxirren shkaqet dhe të përcaktohet përgjegjësia, duke kërkuar edhe zhdëmtim nga personat që kanë pasur përgjegjësinë materiale për administrimin dhe ruajtjen e tyre.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2016

9. Nga auditimi i administrimit të barnave në QSUT, konstatuam se ka një listë shumë të madhe barnash të skaduar në depot farmaceutike. Për vitin 2014 rezultojnë të jenë skaduar 146.863 medikamente në vlerë 38,203,099 lekë, me arsyen se të gjitha këto barna janë blerë në sasi të konsiderueshme dhe që nuk kanë arritur të përdoren, pavarësisht se afati i përdorimit ka qenë relativisht nga 1-2 vjet (blerje nga [] datë 05.07.2012, [] datë 18.06.2012, [] datë 23.07.2013, [] datë 21.07.2011, [] datë 16.07.2012, [] datë 19.06.2014 etj). Për vitin 2015 rezultojnë të jenë skaduar 138.440 medikamente në vlerë 10,163,490 lekë. Megjithatë është konstatuar se këto barna janë blerë në sasi relativisht më të ulët, sërish kemi mospërdorim në kohë të tyre ose sasi të blera mbi nevojat nga vitet e

mëparshme ([REDACTED] datë 30.04.2013, dhe datë 22.07.2013, [REDACTED] datë 09.04.2014, [REDACTED] datë 09.04.2014, [REDACTED] datë 05.03.2015, [REDACTED] datë 19.02.2013, [REDACTED] datë 09.06.2014, [REDACTED] datë 21.05.2012 etj). Kjo gjendje rëndohet më tepër kur konstatohet që donacionet nuk arrijnë të përdoren brenda afatit të tyre të përdorimit, dhe për këto dy vjet barnat e skaduara nga donacionet paraqiten në sasinë 234,405 medikamente në vlerën 124,339,026 lekë.

Kjo situatë tregon se ka një mungesë planifikimi bazuar mbi nevoja reale për medikamente, lidhur me sasinë që është e nevojshme për të mbuluar trajtimin e të sëmurëve të cilët trajtohen në QSUT. Megjithëse blerja e barnave zë rreth 45% (rreth 4 miliardë lekë) të buxhetit vjetor të QSUT, perceptohet një mungesë e theksuar ilaçesh ndërkohë që niveli i barnave të skaduar vijon të jetë i lartë. Konstatohet ndjekje dhe monitorim jo i kujdesshëm i administrimit të barnave në këtë institucion dhe mungesë përgjegjësie institucionale me efekte negative në administrimin e fondeve për barna dhe materiale mjekësore (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 36 - 42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

QSUT të marrë masat e nevojshme për ristrukturimin e sistemit të administrimit dhe qarkullimit elektronik të medikamenteve brenda një kohe të arsyeshme, me qëllim identifikimin e plotë të rrugës që ato ndjekin për të arritur deri te pacienti, përdorimin me efektivitet të këtij sistemi dhe zvogëlimin e abuzimeve dhe neglizhencave gjatë përdorimit të tyre. Programimi i nevojave për barna të nisë me analizën e gjendjes së tyre. Të hartohen kontrata për furnizime fleksibël sipas nevojave të rezultuara dhe jo të orientuara nga shpenzimi i fondeve të prokuruar.

Në vazhdimësi

QSUT të analizojë shkaqet/përgjegjësitë e gjendjes dhe të realizojë asgjësimin e menjëhershëm të barnave të skaduara, duke bashkërenduar veprimet me Ministrinë e Shëndetësisë, Spitalin të Traumës dhe Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim vënien në dispozicion sa më parë të krematoriumit për asgjësimin e tyre.

Menjëherë

10. Konstatohet se në QSUT, është ngritur sistemi i informatizuar “Kartela e Pacientit Spitalor” (shtesë e programit ekzistues “SISP”) për shkarkimin e barnave dhe materialeve mjekësore deri te pacienti. Nga verifikimi rezultoi se programi nuk ofron asnjë raport apo modul për tipin, llojin e barit të konsumuar. Nga programi nuk sigurohet informacioni për ndryshimet e destinacionit të barit, nuk jepet raport për përdoruesit e sistemit (aksesi në sistem, modifikimet, ndryshimet e të drejtave, parametrave, kategorive etj, që realizohen në sistem). Programi gjithashtu nuk gjeneron informacion, për të dhënat e personelit sipas kategorive, specialiteteve, rolit dhe të drejtave që stafi mjekësor ka në sistem, duke e bërë të pamundur dhënien e një opinioni për sigurinë e të dhënave që përmban ky aplikacion. Nga Sektori i IT dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nuk monitorohet hapja e përdoruesve QSUT, duke krijuar/lejuar mundësinë nga përdoruesit e paautorizuar të përdorimit/manipulimit të të dhënave të sistemit (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 104 - 109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

QSUT të marrë masat e nevojshme për ndjekjen dhe monitorimin e aksesimeve, plotësimeve, modifikimeve, ndryshimeve të të drejtave, parametrave, kategorive etj, që realizohen në sistem, për të arritur në dhënien e sigurisë në realizimin e plotë të objektivave të aplikacionit “Kartela e Pacientit Spitalor”.

Menjëherë

11. Konstatuam gjithashtu se aplikacioni “Kartela e Pacientit Spitalor”, është venë në funksion në tetë shërbimeve mjekësore, në kundërshtim me sa është përcaktuar në kontratën fillestare, që parashikon rreth 60 shërbime mjekësore duke komprometuar kryerjen e investimit. Nga auditimi me zgjedhje i “Plotësimi i terapisë ditore të pacientit” në shërbimin mjekësor të Spitalit F..., pjesë e “Kartela e pacientit...” u konstatua se plotësimi i saj

përgjithësisht bëhej kur pacienti ishte larguar nga Spitali, duke e kthyer informatizimin e këtij hapi më tepër në një formalitet se sa një prioritet në shërbim të pacientit. Autoriteti kontraktor, megjithëse e ka marrë në dorëzim aplikacionin “*Kartela e Pacientit Spitalor*” në muajin tetor 2015, ose rreth një vit më vonë se sa është parashikuar, nuk ka identifikuar arsyet/përgjegjësitë për personat shkaktarë të defekteve. Në themel, parregullsitë e konstatuara komprometojnë në tërësi sistemin “*Kartela e Pacientit Spitalor*”, duke konsideruar vet investimin pa efektivitet/dobishmëri reale (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 104 - 109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Për sa më sipër rekomandojmë:

QSUT të marrë masat e nevojshme organizative që aplikacioni “*Kartela e Pacientit Spitalor*” të vendoset në përdorim në të gjitha shërbimet mjekësore të QSUT, në mënyrë që të arrihet sa më shpejt objektivi për të cilin ky sistem është ndërtuar.

Për plotësimin dhe ndryshimet në lidhje me informacionin profesional dhe personal të personelit mjekësor dhe atij referues, si dhe masa në lidhje me monitorimin e modifikimeve në sistem të përdoruesve që nuk janë pjesë e organikës së QSUT. Përmirësimin dhe krijimin e raporteve funksionale në modulën e raporteve për të marrë maksimumin nga ky aplikacion, si dhe pakësimin e kontrolleve manuale.

Menjëherë

12. Nga auditimi i marrëdhënieve kontraktuale për mirëmbajtjen e sistemit të informatizuar “SISP” u konstatua se sistemi i zgjedhur nga AK për raportim “Pentaho”, nuk jep mundësinë e ndryshimit të fjalëkalimit standard, çka cenon rëndë konfidencialitetin e të dhënave sensitive të QSUT, në kundërshtim me nenin 3 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”.

Në sistem nuk janë të hapura të gjitha kodet e barnave që qarkullojnë në “Republikën e Shqipërisë”, por vetëm ato barna që bëhen hyrje në QSUT, çka sjell që në kërkesën ditore të pavijoneve, të mos pasqyrohen/kërkohen të gjithë barnat që mjeku rekomandon në kartelë.

Gjatë përdorimit të “Sistemit ..”, për realizimin e kërkesave për barnat e reja që janë bërë hyrje në Farmacinë Qendrore, krijohen pengesa fiktive dhe konfuzion, sepse programi i ndërtuar, e lejon këtë mundësi. Kërkimi i barnave apo materialeve mjekësore nuk përmban dozën, por vetëm emrin të shoqëruar me kodin ATC. Disa raporte të ndërtuara në sistemin e raportimit, nuk e lehtësojnë punën e përdoruesve për qarkullimin dhe monitorimin e barnave apo materialeve mjekësore, si dhe ndjekjen/realizimin e tyre sipas kontratave.

Planifikimi vjetor për barnat dhe materialet mjekësore, nuk bëhet elektronikisht nga “Sistemi...”, por ai bëhet manualisht, në kundërshtim me objektivat e parashikuar që duhet të ofronte “Sistemi...”, kjo ka sjellë nivele të larta të barnave të skaduar dhe pa mundësi për tu përgjigjur nevojave të pacientëve për barna (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 104 – 111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Për sa më sipër rekomandojmë:

QSUT në bashkëpunim me operatorin ekonomik të marrë masat e nevojshme për zgjidhjen/përmirësimin e mangësive/parregullsive që paraqet sistemi, në veçanti lehtësimin e përdorimit për kërkimin e barnave dhe materialeve mjekësore, përfshirë dozën për çdo bar, hapjen e të gjitha kodeve për barnat që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, realizimin e planifikimit vjetor elektronik në ndihmë të saktësisimit për blerjen e barnave dhe materialeve mjekësore etj.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13. Konstatuam problematika në llogaritje të vlerës së kontratës, vendosjen e kërkesave kualifikuese si dhe në specifikimet teknike në tenderët si:

a) Tenderët të përbërë nga 11 lote (Blerje materiale mjekimi dhe barna për hemodializen dhe hemodinamikën) propozimet për vendosjen e fondeve limite, vendosjen e disa kërkesave

kualifikuese si dhe specifikimeve teknike janë bërë vetëm nga një punonjëse e QSUT-së, me detyrë Shefe e Shërbimit Farmaceutik.

Ky veprim bie ndesh me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, Kreu V, pika 2, germa (a), si dhe me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 33/7/2013 “Për gjurmët standard të auditimit të prokurimeve me vlerë të vogël dhe të lartë”, dispozita në atë kohë në fuqi.

Gjithashtu nuk është kryer analiza e kostove të mallrave, që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e përkatës dhe specifikimet teknike, natyrisht duke i dokumentuar ato në çdo rast, siç përcakton VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, Kreu II, pika 2, germa (ç).

b) Në tenderin “Blerje materiale mjekimi për nevojat e shërbimit të hemodinamikes i ndarë në 7 lote”, llogaritja e fondeve limit cilësohet se është kryer studimi i tregut dhe janë marrë ofertat përkatëse, dokumente të cilat në fakt nuk ka të bashkëlidhur në dosje. Kryerja e këtij veprimi bie ndesh me Urdhrin e MF të sipër cituar, që ka si referencë ligjore VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, Kreu II, pika 2,c, Kreu V pika 2/a.

Është vendosur ndarja në 4 lote (për tenderin e hemodializës), ndër të cilat 3 lote janë për blerje materiale mjekimi dhe një për blerje barnash. Këto ndarje nuk janë homogjene siç përcakton legjislacioni i prokurimeve publike në fuqi. Gjithashtu është përcaktuar paraqitja e certifikatave ISO 9001 dhe ISO 13485 apo certifikatave të tjera pa marrë më parë dijeni organet përkatëse që kanë të drejtë të lëshojnë të tilla certifikata të njohura nga sistemet e standardizimit shqiptar, evropian ose ndërkombëtar, siç përcakton VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu II, pika 3, germa (ç).

Disa nga kërkesat kualifikuese, nuk i kanë vendosur dhe argumentuar me hollësi, veprime të cilat bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, të miratuar me VKM nr. 1, datë 10/01/2007, me ndryshimet, Kreu V, si dhe neni 46 i LPP.

Duke parë për disa fonde të konsiderueshme në lidhjet e kontratave, autoriteti kontraktor duhet të kishte bashkëpunuar me Avokaturën e Shtetit para hartimit dhe nënshkrimit të kontratave administrative (të përcaktuar në nenin 151 të Kodit të Procedurës Administrative-ligji nr. 8485, datë 12.05.1999, me ndryshimet).

U konstatuan raste, që të gjithë anëtarët e KVO-ve kanë të njëjtat argumentime për të tre vlerësimet e dokumenteve, si financiare, teknike dhe faktike, në një kohë, që konkurenti ka mangësi vetëm për dokumentacionin “teknik”. Gjithashtu KVO-ja ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorët e ekonomik pjesëmarrës në tenderin me 7 lote, me objekt “Blerje materiale mjekimi për nevojat e shërbimit të hemodinamikës në QSUT”, që janë paraqitur me katalogë të pa përkthyer në gjuhën shqipe.

Mos kryerja e këtyre veprimeve bie ndesh me rregullat e prokurimit publik në fuqi, e konkretisht me DST, seksioni IV. 6 “Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje”, Kreu III, pika 2, germa (c). Si rezultat ky tender duhej të ishte anuluar dhe procedura të përsëritej nga e para (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 62 - 73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Për sa më sipër rekomandojmë:

Autoriteti kontraktor për të ardhmen, në respektim të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi të marrë masat e nevojshme, që të krijojë komisione me specialistë për llogaritjen e fondeve limite, vendosjen e specifikimeve teknike dhe kërkesave kualifikuese sipas llojeve të procedurave të prokurimit;

Të mos miratohet asnjë fond limit për prokurim pa kryer analizat e kostove të mallrave, shërbimeve apo ndërtimeve, duke bërë krahasimet e elementeve përkatës dhe specifikimeve teknike. Vendosja e fondeve limite nga studimi i tregut, të mos miratohet pa u shoqëruar me praktikë të plota dokumentare, të cilat detyrimisht duhet të jenë pjesë e dosjeve të tenderëve dhe të përfshihen edhe në inventarin e saj.

Vendosja e kërkesave kualifikuese të bëhet duke cilësuar në mënyrë konkrete paraqitjen e dokumentit prove si dhe duke cilësuar edhe emrat konkretë të institucioneve apo organeve që lëshojnë këto dokumente. KVO-të gjatë procesit të vlerësimeve të operatorëve ekonomik, për rastet që nuk plotësojnë kërkesat kualifikuese, të hedhin në platformën elektronike, vetëm në rubrikën që mungon dokumenti përkatës dhe të mos veprohet, që mungesa e një dokumenti teknik të hidhet si mungesë në dokumentin financiar apo në dokumentacionin faktik.

Në vazhdimësi

14. Gjatë auditimit të procedurave ligjore për dhënien me qira të 10 objekteve, subjekteve privatë, u konstatua se praktikat dokumentare nuk janë përqendruar në një drejtori të vetme, dhe vet institucioni nuk e ka ushtruar detyrimet si njësi qendrore monitorimi, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 të Kreut VI të VKM nr. 54, datë 5/2/2014, me ndryshimet, *trajtuar më hollësisht në faqen nr. 62 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Për sa më sipër rekomandojmë:

QSUT të marrë masat e nevojshme për përqendrimin e të gjithë praktikave dokumentare të dhënies më qira për çdo subjekt si dhe të hartojë dhe të përfshijë në rregulloren e brendshme të saj strukturën përkatëse, e cila do të merret me objektet e dhëna me qira.

Brenda datës 30.06.2016

15. Gjatë auditimit të dosjeve të objekteve të dhëna me qira nga QSUT-ja me sipërfaqe deri në 200 m2, të cilat janë përjashtuar nga konkurrimi, rezultoi se nuk janë të pajisura me dokumentacionin e plotë të parashikuar në VKM nr. 54, dt. 5/02/2014, i ndryshuar, e konkretisht:

- Gentplanet e objekteve nuk janë të plota, pasi nuk janë origjinale dhe të konfirmuara nga drejtuesi i QSUT-së, madje nuk vërtetohet identiteti i ekspertëve topograf, që kanë firmosur, pasi dokumentacioni i hartuar prej tyre nuk shoqërohet me licencat përkatëse të tyre.
- Nuk kanë dokumentacione të vlerave kontabël të objekteve të dhëna me qira, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës;
- Nuk kanë miratime nga organi i vartësisë (MSH) për çdo objekt para se të lidhen kontratat;
- Mbas lidhjeve të kontratave, QSUT-ja nuk i ka dorëzuar me dokumentacion procesverbalesh përkatëse, objektet e dhëna me qira;
- Nuk kanë dokumentacione vendimesh të organit drejtues të QSUT-së (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 24- 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia monitoruese (QSUT-ja) të mos lidhë kontratë për objektet e dhëna me qira, pa u plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuar në legjislacionin përkatës, si dhe të hartohen procesverbalet për përshkrimin e qartë të gjendjeve fizike të pronës, vlerës kontabël të objekteve që jepen me qira, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës dhe detyrimisht të shoqëruara edhe me pamje fotografike.

Në vazhdimësi

16. Janë bërë ndryshime për shtesa të afateve kohore të kontratave të objekteve me qira, të cilave ju ka mbaruar afati kohor, në tre subjekte: [redacted] me kontratën nr. 1848/4, datë 29/8/2013; [redacted] me kontratën datë 15/4/2015 dhe [redacted] për kontratën datë 15/4/2014, me cilësimin “*që i shtrinë efektet e vlefshmërisë me fuqi prapavepruese për disa muaj*”, veprime të pa mbështetura në legjislacionin në fuqi. Për objektet e dhëna me qira gjatë viteve 2014 dhe 2015, nuk janë bërë reflektimet për ndryshimin e tarifave sipas VKM nr. 54, datë 5/02/2014, me ndryshimet (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 24- 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

QSUT-ja të marrë masat, për të ardhmen, për të mos lidhur kontrata me fuqi prapavepruese, si dhe të reflektojë vendosjen e tarifave të miratuara nga VKM nr. 54, datë 5/02/2014, me ndryshimet.

Në vazhdimësi

17. Në kontratën datë 15.03.2013, të lidhur midis ish Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë [REDAKTUAR] sh.p.k, me objekt dhënien me qira të pasurisë “*Tre hyrjedalje dhe gjashtë sipërfaqe parkimi, në QSU-Nënë Tereza, Tiranë, njësi kjo në administrim të QSUT-së, me sipërfaqe të përgjithshme 6,101 m², të gjitha sipërfaqet funksionale*”, me një vlerë rreth 800.000 lekë në muaj. Ndaj subjektit qiramarrës janë përcaktuar detyrime për të kryer investime gjatë 2 viteve të para, ndërkohë që mungon monitorimi dhe praktikat e plota dokumentare në zbatim të legjislacionit në fuqi për të mundësuar verifikimin e investimit sipas kushteve të kontratës (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 24 - 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

QSUT të marrë masat e nevojshme për të saktësuar vlerat e investimeve të kryera të shoqëruar me dokumentacion e plotë justifikues ligjor për 2 vitet e para, nëse ato janë kryer atëherë të marrë në dorëzim, pjesën e përmirësimit të investimeve, që janë të pa ndashme nga prona, në zbatim të kontratës përkatëse, duke ja kaluar Drejtorisë Ekonomike të QSUT, për kontabilizim në rritjen e aktiveve, në të kundërt shoqëria [REDAKTUAR] sh.p.k. ti paguajë QSUT-së penalitetin e llogaritur në vlerën prej **3,814 mijë lekë**.

Brenda datë 30.04.2016

18. Në vazhdim të proceseve gjyqësore ndaj QSUT, u konstatua rasti i mjekut kirurg pranë Shërbimit të Kirurgjisë *Maxilo Faciale*, të cilit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë Nr. 346, datë 24.05.2013, “*Për shfuqizimin e procedurës së konkurrimit për mjek kirurg oro-maxilo-facial pranë Shërbimit të Kirurgjisë Maxilo Faciale në QSU “Nënë Tereza”*”. Me Vendimin nr. 1130, datë 05.03.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, me Vendimin nr. 1887, datë 17.09.2013, është vendosur anulimi i aktit administrativ “Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 346, datë 24.05.2013, ndërkohë konstatohet mos ekzekutimi i këtij vendimi nga QSUT justifikuar me mungesën e pozicioneve vakante për Mjek Kirurg Oro Maxilo Facial (*trajtuar më hollësisht në faqen nr 17-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Fillimin nga ana e QSUT të procedurës administrative, për kërkimin në rrugë zyrtare të miratimit të një shtese në organikën e QSUT ku të parashikohet shtimi i pozicionit të kirurgut oro-maxilo-facial, në zbatim të Vendimit nr. 1130, datë 05.03.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, me Vendimin nr. 1887, datë 17.09.2013.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Dëm ekonomik i shkaktuar është **70,221,383 lekë** gjithsej, nga i cili:

B.I. I arkëtueshëm 33,602,383 lekë, për të cilin kërkohet të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 33,602,383 lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, si më poshtë:

1. OE [REDAKTUAR] sh.p.k. vlerën 7,848,523 lekë, për shkak se në tenderin me objekt “Ndërtimi i bunkerit të akseleratorit linear në Spitalin Onkologjik” i zhvilluar në vitin 2014, në preventiv, krahas zërave të ndërtimit, janë parashikuar/likuiduar dhe vlera e TVSH për

pajisje/aparatura, në kundërshtim me kundërshtim me germën A/7 paragrafi i fundit i UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” , në të cilën është përcaktuar se ... në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat (trajtuar më hollësisht në faqen nr 51-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

2. BOE [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. vlerën 4,747,727 lekë për shkak se në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i ndërtesës së ish laboratorëve...” i zhvilluar në vitin 2015, në preventiv, krahas zërave të ndërtimit, janë parashikuar/likuiduar dhe vlera e TVSH për pajisje/aparatura, në kundërshtim me kundërshtim me germën A/7 paragrafi i fundit i UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” , në të cilën është përcaktuar se ... në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat (trajtuar më hollësisht në faqen nr 54-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

3. BOE [REDAKTUAR] person fizik, [REDAKTUAR] sh.p.k. dhe [REDAKTUAR] të përfaqësuar nga subjekti “R...P...” person fizik, vlerën 2,536,677 lekë në tenderin me objekt “Hartimi i projektpreventivit të zbatimit për ndërtimin e bunkerit të akseleratorit linear në Spitalin Onkologjik” i zhvilluar në vitin 2014 nga e cila:

3.1. Vlera 914, 304 lekë, për shkak se ka përfituar pagesa nga QSUT për individë, të cilët nuk janë pjesë e stafit pjesë e licencave të paraqitur nga BOE fitues në tender.

3.2. Vlera 431,885 lekë, për shkak se për punën e kryer nga punonjësit pjesë e stafit të BOE, sipas licencave përkatëse, ka parashikuar/përfituar pagesa nga QSUT, mbi atë të parashikuar në kontratat përkatëse lidhur midis shoqërive dhe drejtuesve teknikë.

3.3 Vlera 1,190,488 lekë, për shkak se në preventiv, në kapitullin “Punime fasade dhe rifiniturat” ndër të tjerë, janë përfshirë padrejtësisht tre zëra punimesh të panevojshëm për t’u kryer (trajtuar më hollësisht në faqen nr 47-49, 52-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

4. OE [REDAKTUAR] vlerën 2,267,293 lekë, për shkak se në tenderin me objekt “Hartimi i projekt preventivit të zbatimit për ndërtimin e bunkerit në Spitalin Neurologjik”, në preventiv, krahas zërave të ndërtimit, janë parashikuar/likuiduar dhe vlera e TVSH për pajisje/aparatura, në kundërshtim me kundërshtim me germën A/7 paragrafi i fundit i UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” , në të cilën është përcaktuar se ... në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

5. Komisionit të vlerësimit të ofertave të përbërë nga përbërë nga [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] 1,809 mijë lekë, ose nga 603,000 lekë/secili, për shkak se në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i ndërtesës së ish laboratorëve...” i zhvilluar në vitin 2015, nuk kanë skualifikuar BOE [REDAKTUAR] sh.p.k. & [REDAKTUAR] sh.p.k, i cili rezulton me parregullsi në dokumentacionin ligjor kualifikues, pas verifikimit të tyre në sistemin e APP.

BOE [REDAKTUAR] sh.p.k. & [REDAKTUAR] sh.p.k, në vijim të procedurave të tenderit është shpallur fitues. Vlera 1,809 mijë lekë, përfaqëson diferencën midis vlerës së ofertës 58,028 mijë lekë të BOE [REDAKTUAR] sh.p.k. & [REDAKTUAR] sh.p.k, i cili nuk është skualifikuar nga KVO, por është shpallur fitues dhe vlerës të ofertës 56,219 mijë lekë të OE [REDAKTUAR] sh.p.k. i skualifikuar për të njëjtat parregullsi (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 58 – 61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

6. OE [REDAKTUAR] vlerën 12,293,463 lekë, nga e cila:

6.1. Vlerën 9,667,194 lekë, për shkak se në kryerjen e “Shërbimit të hemodializës”, gjatë vitit 2014, kanë kryer mbi 13 seanca/muaj për pacient, në kundërshtim me kontratën

fillestare nr. 2,465/6, datë 22.6.2012, ndryshuar me kontratë shtesë nr. 1522, datë 1.4.2014 etj. lidhur midis palëve, në të cilën është përcaktuar që numri i seancave që do të kryejë një pacient në javë, nuk duhet të jetë më i lartë se tre.

6.2. Vlerën 2,626,269 lekë, për shkak se nga kryqëzimi i të dhënave midis datës së largimit të pacientëve nga pavijoni i nefrologjisë në QSUT, datës në të cilën janë futur për trajtim tek operatori privat dhe numrit të seancave të kryera e faturuara, rezultuan pagesa të kryera, në kohën që pacientët, nuk kanë qenë të shtruar në Spitalin [REDAKTUAR]

Menjëherë

7. Subjektit [REDAKTUAR] sh.p.k. vlerën 600,000 lekë, e cila përfaqëson penalitetet dhe gjobat e llogaritura ndaj subjektit, për shkak të mos zbatimit të kushteve të kontratës datë 15/03/2013 lidhur midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (qiradhënësi) dhe shoqërisë "S....." sh.p.k. (qiramarrësi), me objekt dhënien me qira të pasurisë... "Tre hyrje-dalje dhe gjashtë sipërfaqe parkimi, në QSU-Nënë Tereza, Tiranë", njësi kjo në administrim të QSUT-së, me sipërfaqe të përgjithshme 6,101 m² (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 24 - 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

8. Subjektit [REDAKTUAR] vlerën 1,317,300 lekë (Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr... të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9. Subjektit [REDAKTUAR] vlerën 182,400 lekë, të cilat (pikat 8 dhe 9) përfaqësojnë vlerën e qirave të pa arkëtuara si dhe penalitetet për vonesat në zbatim të kontratave përkatëse, sipas sqarimeve dhënë hollësisht në pasqyrat nr. 5 dhe 6, bashkëlidhur (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 24 - 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

B.II. DËM EKONOMIK, PA MUNDËSI ARKËTIMI NË VLERËN 36,619 MIJË LEKË.

Ky dëm është evidentuar në procedurën e tenderit me objekt "Ndërtimi i Bunkerit për instalimin e dy Akseleratorëve Linearë në Spitalin Onkologjik" me fond limit prej 184,771,422 lekë, fituar nga OE [REDAKTUAR].

Kjo procedurë është mbyllur nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP).

Pavarësisht sa më sipër, kjo procedurë tenderi u auditua dhe në përfundim të saj ndër të tjera rezultoi se:

Në këtë tender kanë paraqitur oferta 11 OE, nga të cilët KVO ka skualifikuar 7 OE. Ka kualifikuar **në vend të parë OE** [REDAKTUAR] sh.p.k, i cili ka paraqitur ofertën ekonomike **me vlerë 183,853 mijë lekë**, e cila rezultoi të jetë më e ulëta e ofertave të ofruara.

Në OE të kualifikuar është dhe [REDAKTUAR] sh.p.k. me vlerë të ofertës 218,472 mijë lekë. OE [REDAKTUAR] sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik (KPP), i cili ka skualifikuar OE [REDAKTUAR] sh.p.k.

KPP ka kualifikuar OE [REDAKTUAR] sh.p.k., i cili rezultoi shtati në renditje për nga vlera e ofertës ekonomike, me **diferencë 36,619 mijë lekë** më shumë se sa oferta e OE [REDAKTUAR] sh.p.k., ose rreth **1 për qind më pak se sa fondi limit**.

Shkaqet që ka paraqitur KPP për skualifikimin e OE [REDAKTUAR] sh.p.k, përmbledhur janë:

1. Nuk ka paraqitur fizikan mjekësor të certifikuar nga KMR.
2. Nuk ka punime të ngjashme. Objekt i tenderit është "Ndërtimi i bunkerit të akseleratorëve ...", e cila është ndërtesë me një kat, me sipërfaqe rreth 400 m², kryesisht me beton. OE [REDAKTUAR] sh.p.k. për sa më sipër ka paraqitur:

- Kontratë të lidhur me Institutin e Mbrojtjes nga Rrezatimet (IMR), në përputhje me formatin e kërkuar në KVK nga AK.

IMR është i njohur nga KMR si “Ekspert i autorizuar në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese” prej vitit 2009. Lista e “Ekspert i autorizuar në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese” është e aksesueshme në çdo kohë në faqen e internetit të MSH.

Tërheq vëmendje fakti që në të njëjtën listë të miratuar nga KMR, pak më poshtë Institutit, është dhe emri i fizikanit mjekësor, i cili ka lidhur kontratë me OE [REDAKTUAR] sh.p.k.

KPP ka njohur/konsideruar të vlefshëm kontratën e OE [REDAKTUAR] sh.p.k. me individin dhe nuk ka njohur kontratën e lidhur nga IMR me OE [REDAKTUAR] sh.p.k.

- Për punime të ngjashme “Një godinë 6 kate”, ndërtimi i Universitetit [REDAKTUAR]

Në arsyetimin e KPP, ky ndërtim, nuk është i ngjashëm me “Ndërtimin e bunkerit ...” me një kat. KPP, ka rrëzuar klasifikimin e KVO duke e skualifikuar OE [REDAKTUAR] sh.p.k. me ofertë me vlerë **36,619 mijë lekë më pak** (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 62 - 63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

C. MBI ZBATIMIN ME EFICENSË, EFIKASITET DHE EKONOMICITET TË FONDEVE PUBLIKE.

C.1. Përdorim pa eficientë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publik me vlerë **59,751 mijë lekë**, për shkak të pranimit/dhënies së shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore nga QSUT, subjekteve privatë.

Midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe [REDAKTUAR] është lidhur “Kontratë blerje për pajisje mjekësore ...” datë 20 tetor 2010 në Vjenë, me vlerë 7,100,000 euro. Në kontratë është përcaktuar që shërbimi i “Mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore ...” do të bëhet nga stafi teknik/inxhinierik i QSUT.

Gjatë vitit 2014 Ministria e Shëndetësisë ka zhvilluar tender me objekt “Mirëmbajtje e përqendruar e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Siemens” dhe në zbatim të tij ka autorizuar QSUT të lidhë kontratë me OE fitues. Vlera e kontratës është 133,141,200 lekë, për 7 pajisje, për dy vjet.

Në këtë kontratë shërbimi janë përfshirë dhe dy pajisje mjekësore me emërtim, skaner dhe akselerator me vlerë mirëmbajtje 79,560 mijë lekë gjithsej, të cilat janë pjesë e kontratës me vlerë 7,100,000 euro lidhur në Vjenë.

Përfshirja e dy pajisjeve skaner dhe akselerator në kontratën e shërbimit të “Mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore ...” është në kundërshtim me sa është parashikuar në nenin 20 “Trajnimi”, aneksin C të kontratës me të njëjtin emërtim “Trajnimi” etj, të “Kontratë blerje” me vlerë 7,100,000 euro lidhur në midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe [REDAKTUAR] për rrjedhojë vlera e kontraktuar prej 79,560 mijë lekë gjithsej, paraqitet potencialisht si shpenzim jo efektiv, i cili është realizuar proporcionalisht me masën e zbatimit të kontratës.

Dhënia e shërbimit të “Mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore” subjekteve privatë dhe jo QSUT, komprometohet edhe më tej, kur evidentohet se:

- për 18 muaj që është realizuar kontrata, janë mbajtur 18 procesverbale, ose një/muaj për shërbimin e mirëmbajtjes dhe në asnjë rast, nuk ka pasur zëvendësim pjese të dëmtuar/konsumuar, për të shtatë pajisjet e parashikuara në kontratën e shërbimit.

- në një material me emërtim “Pasqyrë teknike” dërguar datë 17.4.2014 nga Kontraktori Drejtori i Përgjithshëm i QSUT, ndër të tjera, në germën “B” “Rekomandime nga Siemens” është sqaruar se ... *Siemens rekomandon 4 mirëmbajtje periodike në vit për akseleratorin linear* (jo shërbim ditor/mujor).

[REDAKTUAR] në cilësinë e titullarit/nëpunësit autorizues të QSUT, mbështetur në nenin 8 dhe 9 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar pasi kontrata midis Ministrisë dhe kompanisë austriake është mbyllur në vitin 2014, kohë më të cilën ka qenë (dhe është) titullar/nëpunëse autorizuese e QSUT dhe ka qenë detyrim i saj të njoftonte Ministrinë e Shëndetësisë se kryerja e “Shërbimit të mirëmbajtjes” së pajisjeve mjekësore është detyrë e QSUT.

Për më tepër, me shkresë të OE nr. 657, datë **10.2.2014**, QSUT është njoftuar se ... *ka përfunduar periudha e garancisë për ... disa pajisje të markës “Siemens” ... objekt i*

kontratës ” me vlerë 7,100,000 euro lidhur në midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe [REDAKTUAR] në të cilën përfshihen dhe dy pajisjet akseleratorë dhe skaner.

Në vijim të njoftimit subjekti privat shprehet se... *do t'ju luteshim që këto pajisje të përfshihen në kontratë mirëmbajtje ...*

Nga ky moment, deri datë 28.8.2014 që është autorizuar lidhja e kontratës së shërbimit të “Mirëmbajtje pajisje mjekësore...” me subjektin privat, QSUT, ka pasur gjithë kohën e nevojshme për zbatimin e kushteve të kontratës lidhur midis ministrisë/kompani austriake, në respekt të pikës 24/2 të nenit 24 të kësaj kontratës në të cilën është përcaktuar se ... *Kontrata do të përfundojë me përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve të të dyja palëve si përcaktohet në Kontratë.*

Prej datës 10.2.2014 deri datë 28.8.2014 pajisjet mjekësore nuk kanë qenë nën kontratë shërbimi dhe për to, nuk dokumentohet të jetë kryer ndonjë shërbim.

Vlen të theksohet se në spitalet e vendit janë 11 pajisje Siemens gjithsej, të cilat mirëmbahen nga operatori kontraktor me 4 punonjës, të trajnuar me rreth 35 ditë gjithsej te kompania [REDAKTUAR] *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 91 - 95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

C.2. Në QSUT, çdo spital ka sallën e vet të kirurgjisë, veglat përkatëse të nevojshme për operacion dhe pjesën mbështetëse/pajisjet për sterilizimin e veglave.

Shërbimi i sterilizimit është i organizuar sipas shërbimeve mjekësore nëpërmjet pajisjeve mjekësore, autoklavave të modeleve të ndryshme.

Aktualisht autoklavat janë të instaluar në sallat e operacioneve, në shërbimet mjekësore të Spitalit të Ortopedisë, Kardiokirurgjisë etj, dhe përdoren nga personeli infermier i sallës së operimit, krahas detyrave të tjera funksionale.

Gjithsej janë në funksionim 27 autoklava me të cilat përballohet normalisht, shërbimi i sterilizimit, për këtë arsye prej vitit 2011 e në vazhdim, QSUT, nuk ka kërkuar fonde për blerje autoklava.

Për zhvillimin e QSUT, para vitit 2011 ishte parashikuar një master plan. Pjesë e master planit ka qenë dhe ndërtimi i një spitali të ri aktualisht i njohur si Spitali i Urgjencave, i cili përmbante kryerjen e përqendruar të gjithë ndërhyrjeve kirurgjikale dhe “Shërbimit të sterilizimit”.

Qëllimi, për të rritur cilësinë, për të shfrytëzuar më mirë hapësirat, për të ulur kostot etj. Në zbatim të “master planit”, për “Shërbimin e sterilizimit të përqendruar ” në vitin 2011 janë blerë me “kredi” tërësisht pajisjet përkatëse, moderne, me vlerë 80,688 mijë lekë për gjithë QSUT, të cilat aktualisht janë të hapura dhe gjenden në një kat të Spitalit të Urgjencës që njihet si “Pavijoni i Sterilizimit”, por të pavendosura në punë.

Ajo që ndodh në këtë situatë është se pajisjet, për defektet e mundshme që mund të evidentohen gjatë vendosjes në punë, do të shoqërohen me kosto shtesë, pasi janë jashtë afatit të garancisë së shitësit, një vit, veç dëmtimeve eventuale fizike etj, që mund të kenë pësuar dhe pësojnë deri në vënien e tyre në punë.

Në përfundim të auditimit konstatohet se QSUT ka në zotërim një kapacitet sterilizues mbi dyfishin e nevojave të saj dhe me kosto maksimale mirëmbajtjeje dhe blerje vegla mjekësore për operacione, deri 5,000 mijë lekë/vit *(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 117 - 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

QSUT të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të përcaktuar shkaqet/përgjegjësitë e kësaj gjendjeje. Në vijim QSUT, në bashkërendim me Ministrinë e Shëndetësisë, të bëjë shpërndarjen/përdorimin e tyre në spitale të tjerë në vend, duke lejuar amortizimin e mëtejshëm të pajisjeve dhe përdorimin pa efektivitet, vlerave të konsiderueshme monetare.

D. MASA DISIPLINORE.

D.1. Mbështetur në nenin 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe pikën 4 të VKM nr. 70, datë 15.2.2001 “Për statusin e spitaleve universitare” i ndryshuar, për përmirësimin e

gjendjes, i rekomandojmë Kryeministrin të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga detyra” për [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, për arsye se:

1.1. Në tenderin me objekt dhënien e shërbimit të “Mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore” zhvilluar në vitin 2014 nga MSH, nuk ka bashkëvepruar me të, për të saktësuar se ky shërbim, në zbatim të kontratës lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe [REDAKTUAR] datë 20 tetor 2010 në Vjenë, me vlerë 7,100,000 euro, është përcaktuar të bëhet nga QSUT.

Si rezultat i këtij veprimi/mosveprimi, QSUT rezulton të ketë shpenzuar fonde publike pa efektivitet deri në përfundim të auditimit në vlerën **59,751 mijë lekë**.

Përmbledhur.

Gjatë vitit 2014 Ministria e Shëndetësisë ka zhvilluar tender me objekt “Mirëmbajtje e përqendruar e disa pajisjeve mjekësore të prodhuesit Siemens” dhe në zbatim të tij ka autorizuar QSUT të lidhë kontratë me OE fitues. Vlera e kontratës është 133,141,200 lekë, për 7 pajisje, për dy vjet.

Në këtë kontratë shërbimi janë përfshirë dhe dy pajisje mjekësore me emërtim, skaner dhe akselerator me vlerë mirëmbajtje 79,560 mijë lekë gjithsej, të cilat janë pjesë e kontratës me vlerë 7,100,000 euro lidhur në Vjenë.

Përfshirja e dy pajisjeve skaner dhe akselerator në kontratën e shërbimit të “Mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore ...” është në kundërshtim me sa është parashikuar në nenin 20 “Trajnimi”, aneksin C të kontratës me të njëjtin emërtim “Trajnimi” etj, të “Kontratë blerje” me vlerë 7,100,000 euro lidhur në midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe [REDAKTUAR] për rrjedhojë vlera e kontraktuar prej 79,560 mijë lekë gjithsej, paraqitet potencialisht shpenzim pa efektivitet, i cili është realizuar proporcionalisht me masën e zbatimit të kontratës.

Dhënia e shërbimit të “Mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore” subjekteve privatë dhe jo QSUT, komprometohet edhe më tej, kur evidentohet se:

- në një material me emërtim “Pasqyrë teknike” dërguar datë 17.4.2014 nga OE kontraktor [REDAKTUAR] Drejtor i Përgjithshëm i QSUT, ndër të tjera, në germën “B” “Rekomandime nga Siemens” është sqaruar se ... *Siemens rekomandon 4 mirëmbajtje periodike në vit për akseleratorin linear (jo shërbim ditor/mujor).*

- për 18 muaj që është realizuar kontrata, janë mbajtur 18 procesverbale, ose një, në muaj për shërbimin e mirëmbajtjes dhe në asnjë rast, nuk ka pasur zëvendësim pjese të dëmtuar/konsumuar, për të shtatë pajisjet e parashikuara në kontratën e shërbimit.

[REDAKTUAR] në cilësinë e titullarit/nëpunësit autorizues të QSUT, mbështetur në nenin 8 dhe 9 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” është përgjegjëse për shpenzimet e kryera pa efektivitet pasi kontrata midis ministrisë dhe kompanisë austriake është mbyllur në vitin 2014, kohë më të cilën ka qenë (dhe është) titullar/nëpunëse autorizuese e QSUT dhe ka qenë detyrim i saj të njoftonte Ministrinë e Shëndetësisë se kryerja e “Shërbimit të mirëmbajtjes” së pajisjeve mjekësore është detyrë e QSUT.

Pë më tepër, me shkresë të operatorit kontraktor nr. 657, datë **10.2.2014**, QSUT është njoftuar se ... *ka përfunduar periudha e garancisë për ... disa pajisje të markës “Siemens” ... objekt i kontratës* ” me vlerë 7,100,000 euro lidhur në midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe A..., në të cilën përfshihen dhe dy pajisjet akseleratorë dhe skaner.

Në vijim të njoftimit subjekti privat shprehet se... *do t’ju luteshim që këto pajisje të përfshihen në kontratë mirëmbajtje ...*

Nga ky moment, deri datë 28.8.2014 që është autorizuar lidhja e kontratës së shërbimit të “Mirëmbajtje pajisje mjekësore...” me subjektin privat, QSUT, ka pasur gjithë kohën e nevojshme për zbatimin e kushteve të kontratës lidhur midis ministrisë/kompanisë austriake, në respekt të pikës 24/2 të nenit 24 të kësaj kontratës në të cilën është përcaktuar se ... *Kontrata do të përfundojë me përmbyshjen e të drejtave dhe detyrimeve të të dyja palëve si përcaktohet në Kontratë.* Prej datës 10.2.2014 deri datë 28.8.2014 pajisjet mjekësore nuk kanë qenë nën kontratë shërbimi dhe për to, nuk dokumentohet të jetë kryer ndonjë shërbim.

1.2. Në QSUT, çdo spital ka sallën e vet të kirurgjisë, veglat përkatëse të nevojshme për operacion dhe pjesën mbështetëse/pajisjet për sterilizimin e veglave.

Shërbimi i sterilizimit është i organizuar sipas shërbimeve mjekësore nëpërmjet pajisjeve mjekësore, autoklavave të modeleve të ndryshme.

Aktualisht autoklavat janë të instaluar në sallat e operacioneve, në shërbimet mjekësore të Spitalit të Ortopedisë, Kardiokirurgjisë etj, dhe përdoren nga personeli infermier i sallës së operimit, krahas detyrave të tjera funksionale.

Gjithsej janë në funksionim 27 autoklava me të cilat përballohet normalisht, shërbimi i sterilizimit, për këtë arsye prej vitit 2011 e në vazhdim, QSUT, nuk ka kërkuar fonde për blerje autoklava.

Për zhvillimin e QSUT, para vitit 2011 ishte parashikuar një master plan. Pjesë e master planit ka qenë dhe ndërtimi i një spitali të ri aktualisht i njohur si Spitali i Urgjencave, i cili përmbante kryerjen e përqendruar të gjithë ndërhyrjeve kirurgjikale dhe “Shërbimit të sterilizimit”.

Qëllimi, për të rritur cilësinë, për të shfrytëzuar më mirë hapësirat, për të ulur kostot etj. Në zbatim të “master planit”, për “Shërbimin e sterilizimit të përqendruar” në vitin 2011 janë blerë me “kredi” tërësisht pajisjet përkatëse, moderne, me vlerë 80,688 mijë lekë për gjithë QSUT, të cilat aktualisht janë të hapura dhe gjenden në një kat të Spitalit të Urgjencës që njihet si “Pavijoni i Sterilizimit”, por të pavendosura në punë.

Ajo që ndodh në këtë situatë është se pajisjet, për defektet e mundshme që mund të evidentohen gjatë vendosjes në punë, do të shoqërohen me kosto shtesë, pasi janë jashtë afatit të garancisë së shitësit, një vit, veç dëmtimeve eventuale fizike etj, që mund të kenë pësuar dhe pësojnë deri në vënien e tyre në punë.

Në përfundim të auditimit konstatohet se QSUT ka në zotërim një kapacitet sterilizues mbi dyfishin e nevojave të saj dhe me kosto maksimale mirëmbajtjeje dhe blerje vegla mjekësore për operacione, deri 5,000 mijë lekë/vit.

Përballë kësaj situatë titullari i QSUT nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të përcaktuar shkaqet/përgjegjësitë e kësaj gjendje.

Në tërësi nga veprimet e mësipërme dallohet qartë performanca e ulët dhe përdorimi pa efikasitet, efikasitet dhe ekonomikitet i fondeve publike, i shoqëruar me efekte financiare negative.

D.2. Mbështetur në nenin 37, 144 dhe 145 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara, për personat si më poshtë:

1. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike për shkak se:

- Në situacionin përfundimtar, i cili është miratuar edhe nga Dega e Thesarit Tiranë, vlera e artikullit “paga, shpërblime e shpenzime të tjera personeli” në kolonën plan e raportuar nga Sektori i Buxhetit është 50,000 mijë lekë, më e lartë se sa vlera e raportuar nga Sektori i Financës, e cila është konsideruar si fond/shpenzim i kursyer nga QSUT.

I njëjti fenomen u konstatua edhe për artikullin “Transferta buxhete familjare/llog. 606”, i cili duhet të raportohet në kolonën plan me një vlerë 87 mijë lekë më tepër.

- Nuk ka zbatuar urdhrat e titullarit të autoritetit kontraktor nr. 332, datë 27/10/2014 dhe nr. 91, datë 23/03/2015, për monitorimin dhe zbatimin e kontratës së parkimit të automjeteve në QSUT, të lidhur me shoqërinë “S.....” sh.p.k. e cila ka rezultuar me parregullsi jo vetëm dokumentare, por edhe me dëm ekonomik.

2. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës i Sektorit Investimeve & Infrastrukturës, si punonjës kryesor i ngarkuar për monitorimin e objekteve të dhëna me qira, për të cilën u konstatuan të meta në lidhje me zbatimin e VKM nr. 54, datë 5.02.2014 dhe VKM nr. 735, datë 5.11.2014. për shkak se nuk ka zbatuar dy urdhrat e titullarit të QSUT-së nr. 332, datë 27/10/2014 dhe

nr. 91, datë 23/03/2015, të caktuar për monitorimin dhe zbatimin e kontratës së parkimit të automjeteve në QSUT-së, të lidhur me shoqërinë “S.....” shpk me pasojë:

- Mos realizimin e numrit prej 16 punonjës në vit, i parashikuar në kushtet e kontratës, i cili e penalizon subjektin qiramarrës “S.....” sh.p.k. në vlerën në vlerën 600,000 lekë,

- Mos dokumentimi i realizimit të investimeve të kryera sipas legjislacionit në fuqi, i cili shoqërohet me penalitet ndaj subjektit qiramarrës “S.....” sh.p.k. me vlerën 3,813,600 lekë (*trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, kapitulli 6-Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënie të ambienteve me qira subjekteve private, respektimi i tarifave të qirasë, si dhe ndjekja e arkëtimit të të ardhurave*).

3. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës i Sektorit Transportit; E...B me detyrë Jurist në Drejtorinë Juridike,

4. [REDAKTUAR] me detyrë ekonomiste në Drejtorinë Ekonomike,

5. [REDAKTUAR] me detyrë juriste në Drejtorinë Juridike,

6. [REDAKTUAR] me detyrë Inxhinier i Sektorit Investimeve & Infrastrukturës,

7. [REDAKTUAR] me detyrë inxhinier i Sektorit Investimeve & Infrastrukturës në cilësinë e pjesëtarëve të grupeve të punës, për shkak se nuk kanë zbatuar dy urdhrat e titullarit të QSUT-së nr. 332, datë 27/10/2014 dhe nr. 91, datë 23/03/2015, të caktuar për monitorimin dhe zbatimin e kontratës së parkimit të automjeteve në QSUT-së, të lidhur me shoqërinë [REDAKTUAR] shpk me pasojë:

- Mos realizimin e numrit prej 16 punonjës në vit, i parashikuar në kushtet e kontratës, i cili sipas kushteve të kontratës e penalizon subjektin qiramarrës [REDAKTUAR] sh.p.k. në vlerën në vlerën 600,000 lekë,

- Mos dokumentimi i realizimit të investimeve të kryera sipas legjislacionit në fuqi, i cili shoqërohet me penalitet ndaj subjektit qiramarrës [REDAKTUAR] sh.p.k. me vlerë 3,813,600 lekë.

E. TË TJERA

1. Të informohet Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe Departamenti Antikorupsion për shkeljet e konstatuara në procedurat e rishikimit administrativ, nga Komisioni i Prokurimit Publik i përbërë nga [REDAKTUAR] në cilësinë e kryetarit, lidhur me shqyrtimin e ankesës për procedurën e prokurimit të tenderit me objekt “ndërtimi i bunkerit të dy akseleratorëve ...” zhvilluar në vitin 2014 nga QSUT, dhe të vihet në dijeni Kryeministri z. Edi Rama, për sa konstatuar:

Në procedurën e tenderit me objekt “Ndërtimi i Bunkerit për instalimin e dy Akseleratorëve Linearë në Spitalin Onkologjik” zhvilluar në QSUT, me fond limit prej 184,771,422 lekë , fituar nga OE [REDAKTUAR] sh.p.k. KPP ka skualifikuar padrejtësisht OE [REDAKTUAR] sh.p.k, i cili ka paraqitur ofertën ekonomike **me vlerë 183,853 mijë lekë**, e cila rezulton të jetë më e ulëta e ofertave të ofruara.

Pavarësisht se kjo procedurë është mbyllur nga KPP, tenderi u auditua dhe në përfundim të saj ndër të tjera rezulton se:

Në këtë tender kanë paraqitur oferta 11 OE, nga të cilët KVO ka skualifikuar 7 OE. Ka kualifikuar **në vend të parë OE [REDAKTUAR] sh.p.k**, i cili ka paraqitur ofertën ekonomike **me vlerë 183,853 mijë lekë**, e cila rezulton të jetë më e ulëta e ofertave të ofruara.

Në OE të kualifikuar është dhe [REDAKTUAR] sh.p.k. me vlerë të ofertës 218,472 mijë lekë. OE [REDAKTUAR] sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik (KPP), i cili ka skualifikuar OE [REDAKTUAR] sh.p.k.

KPP ka kualifikuar OE [REDAKTUAR] sh.p.k, i cili rezulton shtati në renditje për nga vlera e ofertës ekonomike, me **diferencë 36,619 mijë lekë** më shumë se sa oferta e OE [REDAKTUAR] sh.p.k. , ose rreth **1 për qind më pak se sa fondi limit**.

Shkaqet që ka paraqitur KPP për skualifikimin e OE [REDAKTUAR] sh.p.k, përmbledhur janë:

1. Nuk ka paraqitur fizikan mjekësor të certifikuar nga KMR.
 2. Nuk ka punime të ngjashme. Objekt i tenderit është “Ndërtimi i bunkerit të akseleratorëve ...”, e cila është ndërtesë me një kat, me sipërfaqe rreth 400 m², kryesisht me beton.
- OE ██████ sh.p.k. për sa më sipër ka paraqitur:
- Kontratë të lidhur me Institutin e Mbrojtjes nga Rrezatimet (IMR), në përputhje me formatin e kërkuar në KVK nga AK.
- IMR është i njohur nga KMR si “Ekspert i autorizuar në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese” prej vitit 2009. Lista e “Ekspert i autorizuar në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese” është e aksesueshme në çdo kohë në faqen e internetit të MSH.
- Tërheq vëmendje fakti që në të njëjtën listë të miratuar nga KMR, pak më poshtë Insitutit, është dhe emri i fizikanit mjekësor, i cili ka lidhur kontratë me OE ██████ sh.p.k.
- KPP ka njohur/konsideruar të vlefshëm kontratën e OE ██████ sh.p.k. me individin dhe nuk ka njohur kontratën e lidhur nga IMR me OE ██████ sh.p.k.
- Për punime të ngjashme “Një godinë 6 kate”, ndërtimi i Universitetit “A” Durrës.
- Në arsyetimin e KPP, ky ndërtim, nuk është i ngjashëm me “Ndërtimin e bunkerit ...” me një kat. KPP, ka rrëzuar klasifikimin e KVO duke e skualifikuar OE ██████ sh.p.k. me ofertë me vlerë **36,619 mijë lekë më pak.**

G. KALLËZIM PENAL

KLSH, ka bërë kallëzim penal për ██████ me detyrë mjeke nefrologe, në cilësinë e mbikëqyrësit të kontratave me operatorët privatë për shërbimin e e Hemodializës pasi: Gjatë vitit 2014 ka lejuar/pranuar/ që spitali ██████ të kryej shërbimin e hemodializës me frekuencë mbi 13 seanca/muaj për pacient, në kundërshtim me kontratën fillestare nr. 2,465/6, datë 22.6.2012, ndryshuar me kontratë shtesë nr. 1522, datë/3, datë 1.4.2014 etj. lidhur midis palëve, në të cilën është përcaktuar *që numri i seancave që do të kryejë një pacient në javë, nuk duhet të jetë më i lartë se tre.*

Nga kryqëzimi i të dhënave midis datës së largimit të pacientëve nga pavijoni i nefrologjisë në QSUT, datës në të cilën janë futur për trajtim tek operatori privat dhe numrit të seancave të kryera e faturuara, rezultuan pagesa të kryera, në kohën që pacientët, nuk kanë qenë të shtruar në Spitalin ██████ me vlerë 2,626,269, e cila përbën dëm ekonomik për QSUT.

Nuk ka mbajtur regjistër themeltar, ose dokument tjetër, nuk ka krijuar një database në të cilin të ishte i regjistruar çdo pacient, nëpërmjet së cilës do të evidentohej/verifikohej historiku i pacientëve, gjendja klinike e tyre, kohën në të cilën është futur në shërbimin e dializës, mënyrën se si pacienti është orientuar tek operatori privat për të marrë shërbimin dhe shpenzimet e kryera. Në shërbimin e hemodializës, deri në muajin Maj 2014 janë trajtuar jashtë numrit të përcaktuar në kontrata dhe të pa miratuara nga bordi 166 pacientë me kosto fillestare 10.309 lekë/seanca, ndryshuar në 11.204 lekë /seanca, ku mesatarisht ata kryejnë 13 seanca në muaj, ose llogaritur në vlerë mesatarisht 24,178,232 lekë më tepër se sa vlerat e parashikuara në kontratat përkatëse.

Nga auditimi i likuidimeve të kryera nëpërmjet bankës, në zbatim të kontratave me spitalet private respektivisht ██████ dhe ██████ për shërbimin e dializës gjatë vitit 2014 është paguar shërbimi i transportit për dializantët, ku nga auditimi u konstatua se sipas kushteve të kontratës është përcaktuar se për çdo seancë të kryer çdo pacient do të rimbursohet në vlerën 419 lekë si shpenzime transporti. Nga likuidimi i tyre u konstatua se këto shpenzime bëheshin bazuar thjesht në një listë emërore të paraqitur dhe hartuar nga operatori privat dhe që vuloset nga mjekja nefrologe e QSU zj. ██████. Nga ana e grupit të auditimit u auditua përputhshmëria midis pacientit - seancave që kryente dhe shpenzimit të transportit që merrte, dhe rezultoi se shuma që përfitonte i faturohej dhe kalonte në llogaritë e operatorëve privatë dhe jo pacientëve. Në asnjë rast pacienti nuk është paguar në bazë të numrit të seancave që kryente, si dhe rezultuan raste që personi që listohej te shpenzimet e transportit nuk ishte në listat e pacientëve që faturoheshin për seancat që kryenin pranë spitaleve të operatorëve privatë. Shuma në total e pajustificuar me dokumentacion vërtetues për shpenzimin e transportit llogaritet në vlerën 6,908,656 lekë, e cila ju është likuiduar

operatorëve privat në kundërshtim me nenin 4 dhe 26 e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit: Fatmir Zilja, përgjegjës grupi, Ymer Stafa, Marjola Lleshi, Alkida Llakaj, Elira Cukalla më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Zbatimit të Standardeve dhe Drejtori i Departamentit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT